

VENDIM
Nr.526, datë 2.8.2006

**PËR CAKTIMIN E ANËTARËVE TË KOMISIONIT NDËRKOMBËTAR TË VLERËSIMIT
PËR TENDERIN E HAPUR NDËRKOMBËTAR, PËR NDËRTIMIN, ME RITME TË
PËRSHPEJTUARA, TË SEGMENTIT RRUGOR RRËSHEN-KALIMASH,
PJESË E AUTOSTRADËS DURRËS-KUKËS-MORINË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 29 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit në Republikën e Shqipërisë“, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Caktimin e anëtarëve të Komisionit Ndërkombëtar të Vlerësimit për tenderin e hapur ndërkombëtar, për ndërtimin, me ritme të përshpejtuara, të segmentit rrugor Rrëshen-Kalimash, të autostradës Durrës-Kukës-Morinë, në bazë të propozimit të konsulentit ndërkombëtar Ecorys Group (Ecorys Netherland BV), sipas listës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Caktimin e një fondi, prej 2 000 000 (dy milionë) lekësh, për pagesat për kryerjen e shërbimit, si anëtar i Komisionit Ndërkombëtar të Vlerësimit.

3. Ky fond rialokohet nga fondet e Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, të programuara për sistemin rrugor kombëtar, për vitin 2006, dhe të papërdorura.

4. Ngarkohet Ministria e Financave, Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rugëve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

**LISTA E ANËTARËVE TË KOMISIONIT NDËRKOMBËTAR TË VLERËSIMIT PËR
TENDERIN E HAPUR NDËRKOMBËTAR, PËR NDËRTIMIN, ME RITME TË
PËRSHPEJTUARA, TË SEGMENTIT RRUGOR RRËSHEN-KALIMASH,
TË AUTOSTRADËS DURRËS –KUKËS- MORINË**

Nr.	Emër, mbiemër	Shtetësia
1.	Stephen Raggett	britanike
2.	Gerald Scott	amerikane
3.	Pim Zoeteweyj	holandeze
4.	Mate Jurišić	kroate
5.	Niko Naska	shqiptare